



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:067409

Datë: 20.08.2019

Numri i dokumentit: 00474958

P. nr.1551/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtaren e vetme gjykuese Fitore Daci dhe zyrtarin ligjor Burim Haxhidema, në çështjen penale kundër të pandehurit R.D. nga Fshati K., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par. 4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2234-1/18 e datës 22.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 13.08.2019, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurores së Shtetit Ajtene Zoni të pandehurit R.D., në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.20.08.2019, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: R.D. i lindur me, i pa punë, bujk, i gjendjes shumë të dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka jetuar nga ndihma sociale mirëpo tani përkohësisht i është ndërprerë, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 05.10.2018, rreth orës 13:15, në fshatin K.-Ferizaj, i pandehuri me qëllim të frikësimit, ka kanosur seriozisht të dëmtuarin B.D., ashtu që derisa i dëmtuari me dy punëtorë të tij ishte

duke shkuar me veturë te arat e tij, me të arritur te shtëpia e të pandehurit, i njëjti i kishte dalë në rrugë, fillimisht e ofendon me fjalë fyese të dëmtuarin, e më pas hun në oborrin e tij merr një sopat dhe iu drejtohet me fjalët “ka me të vra ku të gjej në mal, por së pari kam me ti vra peshqit e mëdhenj e pastaj ty”, me ç’ka tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe ankthit.

Me këtë ka kryer veprën penale kanosja nga neni 185 par. 4 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,49,50,51,52,73, nenit 185 par. 4 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej prej 3 (tre) muaj dhe i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.

Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të pandehurin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit-familjes së tij, pasi që është i gjendjes shumë të rëndë ekonomike si dhe ka qenë përfitues i ndihmës sociale e cila i është ndalur përkohësisht.

I dëmtuari B. D. nga Fshati K., Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate.

Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2234-1/18 dt.22.11.2018 ka ngarkuar të akuzuarin R.D., për veprën penale kanosja nga neni 185 par.4 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.08.2019 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe pendohet për veprën penale të cilën e kam kryer dhe i premtom gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris ndonjë vepër penale dhe kërkoj nga gjykata për pranimin e fajësisë të ketë rrethana lehtësuese.*

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:
-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit,pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lëndës.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: Më datë 05.10.2018, rreth orës 13:15, në fshatin K.-Ferizaj, i pandehuri me qëllim të frikësimit, ka kanosur seriozisht të dëmtuarin B.D., ashtu që derisa i dëmtuari me dy puntorë të tij ishte duke shkuar me veturë te arat e tij, me të arritur te shtëpia e të pandehurit, i njëjti i kishte dalë në rrugë, fillimisht e ofendon me fjalë fyese të dëmtuarin, e më pas hun në oborrin e tij merr një sopat dhe iu drejtohet me fjalët “ka me të vra ku të gjej në mal, por së pari kam me ti vra peshqit e mëdhenj e pastaj ty”, me ç’ka tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe ankthit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale, e gjendjes shumë të dobët ekonomike, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurës i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Konform nenit 453 par.4 të KPRK-së, gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit-familjes së tij, pasi që është i gjendjes shumë të vështirë ekonomike dhe ka qenë përfitues i ndihmës sociale e cila i është ndaluar përkohësisht.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PENAL,
P.nr.1551/18 datë 20.08.2019.**

Zyrtari ligjor

Burim Haxhidema

Gjyqtare

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.